

Odat e Profesionistëve Shëndetësor (Oda e Mjekëve të Kosovës, Oda e Infermierëve të Kosovës, Oda e Stomatologëve të Kosovës, Oda e Farmacistëve të Kosovës dhe Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës), në cilësi të organizatave profesionale të cilat përfaqësojnë profesionistët shëndetësor sipas lëmvive përkatëse profesionale, në takimin e sotëm konsultativ të mbajtur me datë 20 korrik 2018, lëshojnë këtë:

DEKLARATË E PËRBASHKËT PUBLIKE

Procesi i reformës së administratës shtetërore, i cili përfshinë po ashtu nivelizimin e pagave në sektorin publik, paraqet një nga segmentet elementare në këtë proces për definimin e statusit të punonjësve në sektorin publik në përgjithësi, e në veçanti profesionistëve shëndetësor. Statusi ligjor sa i përket të ardhurave personale, të cilat profesionistët shëndetësor i realizojnë mbi meritën e njohurive dhe shkathtësive profesionale, në asnjë mënyrë nuk mund të jetë i pranueshëm në qoftë se i vë në pozitë diskriminuese profesionistët shëndetësor në raport me shërbyesit të tjerë publik. Ashtu siç është proklamuar përmes mjeteve të informimit, në të cilat është publikuar pjesa tabelare e drafut të Projektligjit për Pagat e Funksonarëve Publik, kategorizimi i tillë i profesionistëve shëndetësor është i papranueshëm dhe diskriminues.

Drafti i tillë kundërshtohet në tërësi nga Odat e Profesionistëve Shëndetësor, për sa i përket nivelizimit dhe kategorizimit të pagave të profesionistëve shëndetësor. Odat e Profesionistëve Shëndetësor përkrahin në tërësi propozimet e proceduara nga Ministri i Shëndetësisë, z. Uran Ismaili, propozime këto të cilat ishin harmonizuar me propozimet konkrete që i janë dërguar Ministrisë së Shëndetësisë përmes përfaqësuesve të Odave. Çdo propozim që do të bie ndesh me propozimet që janë harmonizuar në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Odave të Profesionistëve Shëndetësor, do të jetë i papranueshëm për komunitetin e profesionistëve shëndetësor.

Procedimi i mëtutjeshëm apo miratimi i modaliteteve që do të diskriminonin profesionistët shëndetësor në raport me shërbyesit të tjerë publik, do të jetë fakt i përgjegjësive së Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës për sabotimin dhe dëmtimin e reformës në sektorin publik shëndetësor, e cila është në zhvillim e sipër.

Odat e Profesionistëve Shëndetësor, duke mos përjashtuar mirëkuptimin dhe komunikimin institucional, do të ndjekin dhe do të shtjerrin të gjitha mjetet juridiko-ligjore për të mbrojtur integritetin profesional dhe shoqëror të profesionistëve shëndetësor në Republikën e Kosovës.

Prishtinë, 20 korrik 2018

Kryetari i OMK-së

Dr. Pleurat
Sejdiu, Mr. sci



Kryetari i OIK-ut

Ma. Bsc.. Naser
Rrustemi

Kryetari i OSK-së

Prof. Dr. Kujtim
Shala



Kryetari i OFK-së

Dr.sc. Arianit
Jakupi



Kryetarja e OFTK-së

PhD. P.T. Dafina
Ibrahimi - Kaçuri